



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 gusht 2014
Nr. ref.: RK688/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI68/14

Parashtrues

Fahri Rexhepi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-II-0035 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 23 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fahri Rexhepi nga fshati Tenezhdoll, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin ASC-II-0035 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave), të 23 nëntorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-II-0035 të Kolegjit të Ankesave, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, dhe i pamundësoi të realizojë të drejtën në një pjesë të 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore „Ramiz Sadiku“ (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku“) në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 maj 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI68/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI68/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 26 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 3 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 mars 2010, parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), e cila nuk e kishte përfshirë në listën përfundimtare të punonjësve, të cilët e kanë realizuar të drejtën në pjesën e 20% nga privatizimi, ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

10. Më 24 shkurt 2011, trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Aktvendimin SCEL-09-0001-C1175, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e vendimit të tij, trupi gjykues theksoi:

“Kolegji i Ankesave konsideron se duke pasur parasysh që ankesa ishte ushtruar më tepër se tre muaj pas afatit për parashtrimin e ankesave (afati ligjor për paraqitjen e ankesës kishte skaduar më 27 mars 2009.) (...) nuk ekziston mundësia e kthimit në gjendje të mëparshme dhe ankesa të konsiderohet e afatshme. Prandaj, ankesa hidhet poshtë si e papranueshme”.

11. Më 23 nëntor 2012, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, me Aktvendimin ASC-II-0035, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e trupit gjykues, SCEL-09-001-C1175.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se:

“Vendimet dhe urdhërat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të kundërligjshme, sepse sipas meje gjithherë kam ushtruar ankesat ndaj këtij vendimi dhe urdhëri, mirëpo gjithherë janë refuzuar, me arsyetim se kërkesa është ushtruar pas afatit”.

13. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

“Kërkoj që Gjykata Kushtetuese të merr Vendim të drejtë dhe të detyrojë Dhomën e Posaçme që të merr Aktvendim dhe mua të më sistemojë në listën e punëtorëve 20% nga privatizimi”.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata vëren se që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

16. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.

17. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi ...”.

18. Në bazë të të dhënave në shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e kishte parashtruar kërkesën e tij më 8 prill 2014. Gjykata, në bazë të shkresave në dispozicion, kishte konstatuar se Aktvendimi i Kolegjit të Ankesave, ASC-II-0035, i 23 nëntorit 2012, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 janar 2013, prandaj, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
19. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështjet e Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t’u kontestuar (shih rastin *O’Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).
20. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. ùr. Enver Hasani